




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



GJYKATA E APELIT  
SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 1629 Prot.  
Datë 12.11.20

Nr. 466/Prot  
Datë 27.10.2020

## MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

### NDËRMJET

### GJYKATËS SË APELIT SHKODËR

### DHE

### DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

*« Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 « Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti »*

Sot, më datë 12.11.2020 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve :

Gjykatës së Apelit Shkodër, me adresë: Rruga: F. Et'hem Beutiu, përfaqësuar nga Fuat Kuvolha, këtu e në vijim « *Gjykata* ».

*Dhe*

Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, me adresë: Rr. Barrikadave, nd. Nr. 18, hyrja nr. 6, zyra nr. 10 3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas z. *Ergys Qirici*, këtu e në vijim « *Drejtoria* ».

Duke qene se Palët,

*Vlerësojnë* rëndësinë e sistemit të ndihmës Juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

*Konsiderojnë* se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, efëcente dhe efektive.

*Marrin në konsideratë* politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

*Synojnë*, implementimin efektiv të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, bazuar në parimin e:

- a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit;
- dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

*Konfirmojnë*, angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta dhe për të adresuar nevojat e subjekteve përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017.

*Njohin faktin se* gjykatat janë aktorët kyç në garantimin e funksionimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore dhe se gjykatat ka disponibilitetin maksimal për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike dytësore sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit nr.111/2017.

*Afirmojnë* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

## Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit të dy institucioneve sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël.

## Neni 2 Baza Ligjore

Kjo marrëveshjeje bashkëpunimi bazohet në *nenin 2, nenin 4, nenin 6 shkronja "ç"; nenin 22; nenin 23 të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"*.

## Neni 3 Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore nga gjykata sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural në fuqi ;
- Orientimin e subjekteve përfitues drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, « *Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti* »;
- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese ; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Bashkërendimin në dhënien e informacionit mbi vendimet gjyqësore me objekt « *Kërkesë për ndihmë juridike dytësore* » sipas *Kreut V të ligjit 111/2017 «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti* » dhe *udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 05.08.2020 «Pë rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative* ».
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.

## Neni 4 Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon :

Për Gjykatën : Kryetari FUSAT VJERDHA

Për Drejtorinë : Ergys Qirici, Drejta i Përgjithshëm

Në rast të ndryshimit të njerit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### Neni 5

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### Neni 6

#### Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR GJYKATËN E APELIT  
SHKODËR**

*Fuset Vjerdha*  
*Ergys Qirici*



**PËR DREJTORINË E NDIHMËS  
JURIDIKE FALAS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ergys Qirici**

